


Puna e padukshme e
grave që askush s'do ta
përmendi (Le më ta
paguajë)



2
Paaftësia e qëllimshme
e burrave

M: Ç'më shikon ashtu?

Gj: Hiç, kot. Ti tani punon në arat tona, se ne për punë të kemi marrë.

M: Shko hiq ata gurë atje.

Gj: Burrat nuk punojnë, se të përqesh bota.

M: Ta tregoj unë botën në darkë, po s'të vara me kokë poshtë!

Fragment nga filmi *Përrallë nga e kaluara* (1987)



Nëse nuk i lexon dot këto simbole,
kjo zine është bërë për ty.





Puna Shtëpiake: Puna e Padukshme që Askush Nuk Dëshiron t'a Përmendi (Le më t'a Paguajë)


Puna shtëpiake nuk ka të zot. Megjithatë ajo konsiderohet gjerësisht si punë grash në shoqërinë patriarkale. Nuk di a është punë grash sepse është punë e papaguar, apo nuk paguhet sepse është punë grash?

75% e punës së papaguar në botë është e grave. 22% e kohës së vajzave dhe grave shqiptare shpenzohet për punë të papaguar. Vetëm 3% e burrave.*

Të jesh vajzë dhe grua do të thotë të mbash mbi supe pozicionin më të padëshiruar në familje. Do të thotë të kesh përgjegjësi pastrimin, larjen, hekurosjen, pazarin, gatimin, rritjen dhe edukimin e fëmijëve, menaxhimin e të ardhurave, mbarëvajtjen e shtëpisë, familjes, mbështetjen emocionale të çdo pjesëtari, dhe si qershia mbi tortë, performimin në shtrat sipas qejfit të partnerit. Kompensimi për këtë punë të pambarimtë mund të jetë ndonjë "faleminderit" e rallë, ose "ma la çik fanellën për nesër, se do shoh ndeshjen".

Nëse do të duhej të paguaje nga xhepi një pastruese, kuzhinierë, dado dhe psikologe me kohë të plotë, mbase në vend të birrës me çunat do ishe duke hekurosur.

MA
SILL NJE
PESHQIR
!




A
MA LAVE
BLUZËN E
MILANIT
??
?

PRAPË
BAMJE PËR
DREKË ??
PHAA!



R U
DANÉ,
ÉTO
A
DANÉ.





Paaftësia e Qëllimshme: Arti i Të Bërit Asgjë (Dhe Sikur Nuk Di Asgjë)

Tani, le të flasim për paaftësinë e qëllimshme-një strategji e përdorur nga burrat që zotërojnë artin e "nuk e di si bëhet." Është një mashtrim goxha i gjetur, ku burrat pretendojnë se janë shumë konfuzë në lidhje me detyrat bazike, si blerja e ushqimeve apo kujdesi për fëmijët kur mami po bën punën e saj 9-5.

Kjo taktikë e qëllimshme transferon të gjitha detyrat shtëpiake tek partneret e tyre, të cilat në të vërtetë janë të vetmet që dinë si të funksionojnë në botën reale.

Sepse qartazi, nëse je i keq në diçka, është problemi i dikujt tjetër.

aa
E vërteta është që në këtë sistem, një burrë jo vetëm që ka mangësi në aftësitë bazë për të jetuar, por s'i duhet as t'i mësojë në ndonjë pikë të jetës, sepse nga e ëma, kalon tek e dashura, te gruaja, dhe në fund te vajza apo nusja që do përkujdeset për të në pleqëri.

Mbreti i mbretërisë është në vërtetë një fëmijë i përjetshëm që përgëzohet dhe lartësohet për faktin se nuk bën, nuk di, dhe nuk ka pse jep llogari.

Të dish, dhe të kujdesesh për veten, është në rradhë të parë të kesh respekt për veten.

T'i ndash detyrat dhe të bashkëpunosh në familje është të kesh respekt për partneren.

Ma
më thuaj,
zemër.







T'MË KISH
SE E B

HE THĚNĚ
ĚDA VNĚ





~~LISTA~~ HARTA E PAZAREVE



TE PËRDITSHME PËR BURRIN

Rolet dhe pabarazitë gjinore lindin dhe ushqehen në familje.

Ato përforcohen nga pritshmëritë tradicionale dhe stereotipet. Qysh në moshë të vogël fëmijët vrojtojnë dhe brendësojnë sjelljet e prindërve dhe kujdestarëve të tyre. Familja, si struktura bazë e shoqërisë, luan rol kritik në formimin dhe përforcimin e këtyre normave.





Në një drekë familjare teksa kujtonim histori gazmore me njëri-tjetrin, gjyshja ime tregon se si im atë, kur ishte në shkollë fillore, i kishte dhuruar për 8 Marsin një shportë me detergjentë për pastrimin e shtëpisë. Isha e vogël dhe qesha bashkë me të tjerët, pa kuptuar shumë.

Kjo histori më mbeti në kujtesë. Bashkëngjitur me të, dy figura të gjyshes time; një me përparësen e gatimit gjithmonë lidhur, duke mirëmbajtur shtëpinë; një e fotografisë bardhë e zi në dhomën e ndenjes, kur ajo ishte vajzë e re, me armë në dorë, pasi kishte fituar çmim si qitësja më e mirë.

Gjyshja ime dëshironte që unë të isha djalë.





BURRAT E TJERË BLENË
DHE:

100%
OFF

SHFLETONI PAKETEN
TONË TË BOTIMEVE PËR
BURRA FALAS!!!!

Autor:
Lea Tabaku

Dizajni dhe ilustrimet:
Lea Tabaku

Nën drejtimin e:
Jolin Matraku

Me ndihmën e:
Xhesi Shehu

Publikuar nga:
Kolektivi Zanat

Kolektivi Zanat është një platformë artistike e përbërë nga gjashtë vajza, të cilat përmes projekteve të tyre artistike trajtojnë çështje të pabarazisë shoqërore. Anëtarët e kolektivit janë: Jolin Matraku, Xhesi Shehu, Lea Tabaku, Melisa Koyun, Denisa Suli dhe Antea Vogli.

Të gjitha të drejtat e rezervuara, asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa miratimin e autorit dhe publikuesit.

Mbështetur nga Fondi Kulturor Zviceran, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), zbatuar nga Qendra për Biznes, Teknologji dhe Liderhip (CBTL)



Një projekt i Agjencisë Zvicerane
për Zhvillim dhe bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Zbatuar nga:

CBTL | Center for Business
Technology and Leadership



